



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

URDHËR

Nr. 7, datë 19 / 02 / 2015

PËR

**“MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PËRGJITHSHME BAZË PËR TREGUESIT E
EFEKTIVITETIT DHE CILËSISË SË VEPRIMTARISË SË INSPEKTIMIT DHE
KRITERET E VLERËSIMIT E RAPORTIMIT TË TYRE”**

Në zbatim të nenit 16, pika 2, germa ç të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe VKM nr. 696, datë 16.8.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”,

URDHËROJ:

1. Miratimin dhe zbatimin e Rregullave të Përgjithshme bazë mbi Treguesit e Efektivitetit dhe Cilësisë së Veprimtarisë së Inspektimit dhe Kriteret e Vlerësimit e Raportimit të tyre.
2. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore për zbatimin e këtij urdhri.

Adresa: Rruga: “Frosina Plaku” Nr. 58, Godina e Observatorit Kati 0, Tiranë.

Tel: 042 229765, Fax: 042 228983

www.inspektorati.qendror.gov.al

3. Ky urdhër publikohet në Faqen Zyrtare të Inspektoratit Qendror, www.inspektoratiqendror.gov.al, si dhe iu njoftohet Inspektorateve Shtetërore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM



RREGULLA TË PËRGJITHSHME BAZË PËR TREGUESIT E EFEKTIVITETIT DHE CILËSISË SË VEPRIMTARISË SË INSPEKTIMIT DHE KRITERET E VLERËSIMIT E RAPORTIMIT TË TYRE

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Fusha e zbatimit

Rregullat e përgjithshme për treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, si dhe kriteret e vlerësimit të tyre, që në vijim do të referohen si rregulla të përgjithshme, janë të zbatueshme nga institucionet qendrore të ngarkuara me një ose disa funksione inspektimi në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv, të përcaktuara sipas Ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, që në vijim do të referohen si inspektorate shtetërore, si dhe nga Ministrinë e tyre të linjës për sa i përket hartimit dhe miratimit të rregullave specifike.

Neni 2

Qëllimi dhe kategorizimi i rregullave të përgjithshme

1. Rregullat e përgjithshme kanë për qëllim standardizimin e treguesve të efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarive të inspektimit, për të analizuar, krahasuar dhe vlerësuar në një interval kohe të përcaktuar veprimtarinë dhe punën e inspektorateve shtetërore dhe inspektorëve shtetërorë.
2. Rregullat e përgjithshme, përbëjnë bazën për hartimin dhe miratimin e rregullave specifike për treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, si dhe kriteret e vlerësimit të tyre, nga këtu të shprehura si rregulla specifike dhe kategorizojnë treguesit dhe kriteret e vlerësimit në:
 - a) Tregues dhe kritere vlerësimi për zbatimin e standardeve të Ligjit për Inspektimin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
 - b) Tregues dhe kritere vlerësimi për zbatimin e standardeve të legjislacionit sektorial që rregullon fushën e inspektimit.
3. Treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit përbëjnë bazën e informacionit të raporteve të veprimtarive të inspektimit për çdo inspektorat shtetëror.

KREU II TREGUES DHE KRITERE VLERËSIMI

Neni 3

Tregues dhe kritere vlerësimi për zbatimin e standardeve të Ligjit për Inspektimin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij

Treguesit dhe kriteret e vlerësimit për zbatimin e standardeve të Ligjit për Inspektimin specifikohen në këtë nen si vijon:

1. Inspektime të programuara sipas të cilit inspektorati shtetëror ku numri i inspektimeve të kryera sipas programit të inspektimit është më i madh se numrin e inspektimeve jashtë programit vlerësohet pozitivisht më shumë, me përjashtim të inspektorateve të cilat kryejnë veprimtarinë inspektuese sipas germë dh, të pikës 1, të nenit 25 të Ligjit për Inspektimin.
2. Inspektime të kryera mbi bazë autorizimi dhe njoftimi i tij;
 - a) Inspektorati shtetëror i cili kryen inspektimeve me autorizim kryesisht dhe më shumë se inspektime me autorizim të posaçëm vlerësohet pozitivisht më shumë, me përjashtim të inspektorateve të cilat kryejnë veprimtarinë inspektuese sipas germave nga “c dhe ç” të pikës 2 të nenit 27 të Ligjit për Inspektimin”.
 - b) Inspektorati shtetëror i cili kryen inspektimeve të njoftuara (në rastet kur mosnjoftimi nuk është përcaktuar shprehimisht nga ligji i posaçëm), kryesisht dhe mbi inspektimet pa njoftim vlerësohen pozitivisht më shumë.
3. Kohëzgjatja e inspektimit në autorizim dhe numri i inspektimeve për të cilat është kërkuar shtyrje e kohëzgjatjes së tyre;
 - a. Inspektorati i cili kryen inspektimet brenda kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizim dhe brenda kohëzgjatjes maksimale të veprimtarisë inspektuese në subjekt, vlerësohet pozitivisht më shumë se në rastet kur kohëzgjatja e inspektimit shtyhet apo kalon kohën maksimale të inspektimit në subjekt.
 - b. Në çdo rast shtyrje të inspektimit do të analizohet procedura e ndjekur dhe arsyet që sjellin kompleksitetin e inspektimit, si dhe arsyet se pse ky kompleksitet nuk ishte parashikuar më parë.
4. Rezultati nga marrje mostre dhe analiza e shkeljes së kërkesave ligjore në bazë të tyre, ku inspektorati në të cilin numri i mostrave të marra do jetë pothuajse i barabartë me numrin e shkeljeve të kërkesave ligjore të kryera nga ato subjekte vlerësohet pozitivisht më shumë me qëllim që marrja e mostrave të mos shndërrohet në mjet presioni kundrejt subjekteve të inspektimit.
5. Masat urgjente të marra i cili konsiderohet gjithmonë si punë e dobët nga inspektorati që ka lejuar precipitimin e situatës deri në marrjen e masave urgjente të cilat duhet të jenë në proporcion të drejtë me riskun që paraqesin subjektet e inspektimit. Vlersimi më negativ do të jetë në ato raste kur duhet të ishin marrë masat urgjente, por nuk janë marrë, e të tilla raste mund të klasifikohen edhe si vepra penale.
6. Numri i dënimeve administrative apo masave urgjente të revokuara nga ankimi administrativ për inspektorët.
7. Numri i dënimeve administrative apo masave urgjente të revokuara nga Gjykata Administrative për vendimet e Komisionin të ankimit “Organi epror” pranë inspektoratit përkatës;

8. Numri i dënimeve administrative të vendosura në raport me numrin e procesverbaleve të inspektimit, në varësi të fushës konkrete të inspektimit dhe analizës që i bëhet asaj.
9. Numri i vendimeve të revokuara për shkak të shkeljes së procedurës së inspektimit, e cila duhet të shoqërohet gjithmonë me marrjen e masave të duhura për inspektorët përsëritës, si dhe duhet të pasohet nga trajnime të mëtejshme në procedurë dhe për përsëritësit marrjen e masave disiplinore siç përcaktohen në legjislacionin në fuqi.
10. Respektimi i vendit të inspektimit sipas parashikimeve të ligjit të posaçëm, i cili sjell vlerësim negativ për inspektoratin përkatës në rastet kur inspektimi bëhet në vendin e ushtrimit të aktivitetit dhe nuk karakterizohet nga domosdoshmëria e kryerjes aty edhe sipas ligjit të posaçëm;
11. Numri i dënimeve administrative të ekzekutuara nga inspektorati duke parashikuar si vlerësim pozitiv kur ekzekutimi i dënimeve administrative kryesore apo plotësuese ka qenë në nivele të larta dhe vlerësim negative kur ka ndodhur e anasjellta.
12. Numri i inspektimeve të kryera në raport me ato të planifikuara, si tregues që vlerëson ngarkesën e punës së inspektorateve shtetërore. Treguesi mund të raportohet me numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin në fushën specifike të inspektimit, riskun që ato prodhojnë, numrin e inspektorëve, largësinë fizike të subjekteve të inspektimit, duke analizuar orët efektive dhe jo-efektive të punës së inspektorëve.
13. Numri i dënimeve administrative të vendosura, duke marrë për bazë edhe vlerën absolute e relative të masave administrative “gjoba”, apo propozimeve për revokim autorizimesh, lejesh dhe licencash, apo dënime të tjera.
14. Rregullsia e dokumentimit të inspektimeve, i cili vlerëson saktësinë e plotësimin të dokumentacionit të inspektimeve sipas formateve të inspektimit të miratuara, saktësinë e bazës ligjore mbi të cilët inspektorët shtetërorë marrin vendimet, si dhe hedhjen e të dhënave dhe ndjekjen e hapave procedurale në portalin “e-Inspektimi”.
15. Etika dhe sjellja e inspektorëve shtetërorë, i cili vlerëson respektimin nga ana e inspektorëve shtetërorë të detyrimeve ligjore në bazë të legjislacionit për kodin e etikës dhe sjelljes në administratën civile.

Neni 4

Tregues dhe kritere vlerësimi për zbatimin e standardeve të legjislacionit sektorial që rregullon fushën e inspektimit.

1. Treguesit për zbatimin e standardeve të legjislacionit sektorial hartohen dhe miratohen mbi bazën e objektivave vjetorë dhe afatmesëm strategjikë të inspektoratit shtetëror. Çdo objektiv vjetor dhe afatmesëm strategjik duhet të shoqërohet me tregues konkretë dhe mundësisht të matshëm në kohë, për një vlerësim objektiv dhe krahasues për zbatimin e politikave sipas legjislacionit sektorial.

2. Objektivat vjetorë dhe afatmesëm strategjik, si dhe treguesit dhe kriteret e vlerësimit specifikë për zbatimin e legjislacionit sektorial, miratohen nga Ministrinë e linjës bazuar në legjislacionin sektorial që rregullon fushën e inspektimit.
 3. Treguesit dhe kriteret e vlerësimit për zbatimin e standardeve të legjislacionit sektorial duhet të specifikohen përpara miratimit të programit vjetor të inspektimeve, duke kategorizuar qartë në rezultatet e mundshme të pritshme, sipas kriterëve të vlerësimit, katër nivele vlerësimi, duke specifikuar qartë nivelin për vlerësim negativ.
 4. Në rastet kur, për objektiva të caktuar, është i pamundur specifikimi i niveleve të vlerësimit, është e nevojshme caktimi i të paktën një treguesi sinjalizues, që do të shërbejë si kriter vlerësimi, sasior, cilësor ose përshkruar i mosrealizimit të objektivit në fjalë për inspektoratin shtetëror, kryeinspektorin e inspektoratit shtetëror përkatës, apo për kryeinspektorin rajonal.
- * Vlerësimi për treguesit e nenit 3 dhe nenit 4 të mësipërm, bëhet sipas niveleve nga 1 në 4 (ku 1 është vlerësimi më i dobët dhe 4 më i larti) në bazë të tabelës së Aneksit 2 bashkëngjitur këtyre rregullave.*

KREU V

RAPORTIMI I VEPRIMTARIVE TË INSPEKTIMIT

Neni 5

Raportimi i veprimtarive

Raportet e veprimtarive të inspektimit dorëzohen nga inspektoratet shtetërore pranë Inspektoratit Qendror, në formë shkresore dhe elektronike, sipas afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për inspektimin, për çdo vit kalendarik.

Neni 6

Formati i raportimeve

Raportet e veprimtarisë së inspektimit hartohet nga inspektorati shtetërorë në format përshkruar dhe tabele, sipas formateve në Aneksin 1 dhe 2, bashkëngjitur këtyre rregullave.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 7

Ndërthurja dhe integrimi i treguesve dhe kriterëve të vlerësimit

Treguesit dhe kriteret e vlerësimit, për zbatimin e standardeve të Ligjit për Inspektimin dhe për zbatimin e standardeve të legjislacionit sektorial, do të ndërthuren dhe do të rezultojnë në një vlerësim të vetëm, i cili njëkohësisht do të shërbejë edhe si vlerësim për inspektoratin shtetëror, kryeinspektorin e inspektoratit shtetëror përkatës, apo për kryeinspektorin rajonal për sa i përket zbatimit të standardeve të Ligjit për Inspektimin.

Neni 8

Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve dhe kriterëve të vlerësimit

Treguesit dhe kriteret e vlerësimit do të monitorohen gjatë në vazhdimësi për të përcaktuar nivelet specifike të vlerësimit, të cilat do të miratohen nga Ministritë e linjës sipas Ligjit për Inspektimin.

Neni 9

Përcaktimi i nëpunësve përgjegjës

1. Titullari i inspektoratit shtetëror autorizon nëpunësit përgjegjës, për përcaktimin e faktorëve treguesve të efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarive të inspektimit, si dhe kriterëve të vlerësimit të tyre, të cilët nuk duhet të ushtrojnë funksione inspektuese.
2. Në përmbushjen e detyrës së ngarkuar, nëpunësit përgjegjës sipas pikës 1 të këtij neni, mund të mbështetet nga komuniteti shkencor/profesional të fushës së tyre të inspektimit.

ANEKSI 1

FORMAT PËR RAPORTIN VJETOR TË INSPEKTORATIT SHETËTORË

1. PËRMBAJTJA

Do të tregohen të gjitha rubrikat që do të përmbajë raporti, si dhe anekset në qoftë se ka. Lexuesi ka mundësi të krijojë një ide të menjëhershme për materialin që përmban raporti vjetor.

2. PËRMBLEDHJE

Do të tregohet se çfarë do të përmbajë Raporti mbi veprimtarinë e inspektimit të Inspektoratit Shtetëror (ISH) dhe periudha së cilës i referohet raporti, përfshi gjetjet në veprimtarinë inspektuese të Inspektoratit Shtetëror, problematika e hasur, praktikata e mira, konkluzione.

Historiku i Inspektoratit shtetëror

Do të tregohet se çfarë përfaqëson Inspektorati Shtetëror, kujt i shërben, si është krijuar.

3. HYRJE

Raporti hartohet sipas kërkesave të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe përmbledh aktivitetet dhe arritjet e Inspektoratit shtetëror gjatë Vitit për të cilin bëhet raportimi, në bazë të objektivave të vëna.

Misioni

Përshkruhet se si do të rrisë sigurinë publike në fushën e veprimtarisë shtetërore që mbulon.

Deklarata e misionit

Përshkruhet se si do të sigurojë udhëheqje në promovimin e përgjegjshmërisë dhe integritetit të sistemit inspektues në fushën përkatëse.

Detyrat e Inspektoratit Shtetëror

Inspektorati shtetëror përkatës kryen funksionet e mëposhtme:

1. Kryen inspektime të veprimtarive (sipas funksioneve që ka). Përmbushja e indikatorëve të performancës.
2. Identifikimi i rasteve të shkeljeve, të abuzimit dhe mangësi të tjera që lidhen me programet e Inspektoratit Shtetëror, të informojë për këto parregullsi; rekomandojë veprime korigjuese dhe raport mbi progresin e bërë në korigjimin e mangësive.
3. Veprimet për ndalimin e shmangieve ligjore e papërrputshmërinë dhe veprimeve të paligjshme.
4. Koordinimi i aktiviteteve të Inspektoratit Shtetëror.
5. Koordinimi i inspektimit dhe lehtësimin e bashkëpunimit me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit.
6. Punon ngushtë me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit për të siguruar ndjekjen në kohë të çështjeve penale.

4. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

Qëllimi

1. Për të shtuar vlera për inspektoratin te palët e interesuara nëpërmjet një niveli sa më të lartë menaxhimi, për të përmbushur pritshmëritë dhe nevojat;
2. Identifikimi i rreziqeve në të gjithë vendin dhe kërcënimet nga aktivitetet e paligjshme;
3. Kryerjen e inspektimeve në kohë dhe me saktësi, si dhe ato të përbashkëta sipas programimit vjetor.
4. Zhvillimin e zgjidhjeve inovative për të zbutur rreziqet dhe kërcënimet;
5. Dhënia e informacionit në kohë dhe cilësi për vendimmarrësit;
6. Vlerësimi i kontrolleve të brendshme dhe përmirësime që mbështesin zbatimin e suksesshëm të veprimtarisë së Inspektoratit shtetëror;

Metodologjia

Do të tregohet metodologjia e përdorur për hartimin e këtij raporti si inspektime, analiza laboratorike e shkencore, kontrolle, intervista me palët e interesuara etj.

5. ARRITJET E FUNDIT TË TË INSPEKTORATIT SHETËROR

Do të tregohet se gjatë periudhës që raportohet, Inspektorati Shtetëror implementoi përmirësime (ose jo) të shumta operative për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin dhe për të përmirësuar sigurinë publike në fushën përkatëse dhe llogaridhënien, ku mund të përfshihen:

- Përmirësimi i metodës së raportimit të sistemit për incidentet dhe procesin e shqyrtimit, reduktim i ngarkesës së punës dhe kursimet e shpenzimeve të Inspektoratit shtetëror.
- Inicuar zbatimin e një procesi të kryerjes së efektshme të çështjeve dhe zhvillimin e një menaxhimit elektronik sipas PORTALIT "e-inspektimi" për të përmirësuar përputhjen me procedurat e dokumentuara të inspektimit.
- Përmirësoi menaxhimin për të siguruar vazhdimësi në detyrë për inspektimin.
- Informatizimi i ndjekjes së problematikës sipas sistemit unik.
- Përfshirje në një task force rajonale fokusuar në gjetjen e subjekteve me papërputhshmëri.
- Krijuar një lidhje telefonike për raportimin e parregullsive, të mashtrimit dhe incidenteve.
- Krijuar një zyrë të trajnimit për të rritur kapacitetet e inspektorëve, si dhe për të lehtësuar punën e tyre me trajnimet.
- Inicuar krijimin e një programi të trajnimit profesional për inspektorë të punësuar rishtas.
- Filloi raportimin e informacionit për veprimtarinë e Inspektoratit shtetëror në bazë të të dhënave nga sistemi unik.
- Reduktuar ndjeshëm numri ditëve të inspektimit, si pasojë e planifikimit të inspektimeve mbi bazë risku.
- Etj.

PËRGJEGJËSI SPECIFIKE

Inspektoratit shtetëror siguron një informacion të informatizuar (ose jo) nëpërmjet sistemit unik të inspektimit për të patur informacion për të gjithë aktivitetin e saj, si dhe të dhëna për subjektet (gjurmueshmëria), si:

- Siguron sistemin e raportimit të incidenteve / ngjarjeve për të gjitha fushat e Inspektoratit shtetëror, duke bërë të mundur identifikimin e hershëm të problemeve dhe shpërndarjen në kohë të burimeve të inspektimit dhe masat korrigjuese.
- Mbledh të dhëna në gjithë vendin për subjektet që ka nën mbikëqyrje dhe veprimtaritë e tyre.
- Siguron rrjedhje në kohë të informacionit për menaxhimin e veprimtarisë së Inspektoratit shtetëror dhe përmes zyrës për informim të publikut jep informacion për publikun.
- kryeson përpjekjet për të ruajtur marrëdhënie bashkëpunuese të punës me agjenci të tjera të zbatimit të ligjit.

6. RAPORTIMI SIPAS DEPARTAMENTEVE TË INSPEKTORATIT SHETËROR¹

Përbërja organizative dhe Organigrama

- Përshkrimi i tematikave të inspektimeve të kryera gjatë periudhës që raportohet dhe gjetjet e problematika e tyre.
- Programi i inspektimeve në bazë të metodologjisë së riskut, sipas departamenteve përkatëse dhe mënyra e masa e realizimit të tij.
- Numri i inspektimeve të ndara sipas rasteve të programuara, jashtë programit dhe ato të përbashkëta (shifra, si dhe me %).
- Kohëzgjatja vjetore e inspektimit në vendin e ushtrimit të veprimtarive e krahasuar me atë maksimale të lejuar për inspektimin vjetor.
- Lloji i parregullsive të konstatuara dhe klasifikimi i tyre dhe shkeljet (shifra) të ndara sipas rajoneve.
- Procedura e marrjes së mostrave, testimit dhe rezultatet e analizës për testet e kryera.
- Gjetjet e veçanta të inspektimeve si ato të programuara edhe ato jashtë programit.
- Rastet e korrigjimeve që janë lënë për t'u kryer dhe koha në të cilën ato janë kontrolluar për përmbushjen e tyre dhe çfarë ka rezultuar nga korrigjimet.

¹ Për të gjithë treguesit e performancës hartohet një tabelë përmbljedhëse.

-Njësitë e inspektimit, pra si bëhet ndarja e rajoneve të inspektuara, sipas burimeve njerëzore që ka në dispozicion Inspektoratit shtetëror.

-Incidentet e raportuara para dhe gjatë kontrolleve (shifra) dhe masat urgjente të marra sipas dëmit të shkaktuar.

-Numri i masave administrative dhe lloji i gjobave të vendosura si pasojë e parregullsive të konstatuara dhe ankimmimet e apelimet e kryera. Kallëzimet penale dhe konfiskimet (shifra). Njoftimi i palëve të treta të interesuara për masat e marra ndaj shkeljeve.

-Këshillimet dhe informimet e kryera nga trupat inspektuese për subjektet me qëllim parandalimin e situatave të papajtueshmërisë (shifra).

-Pushata ndërgjegjësimit dhe ato publicitare të kryera.

-Statistikat e prodhuara nga gjithë aktiviteti i Inspektoratit shtetëror sipas mbledhjes, analizës dhe shpërndarjes së të dhënave dhe informacioneve për veprimtarinë e subjekteve (shifra).

-Numri i bizneseve të ndaluara si veprimtari të paligjshme (pa licensë) (shifra). Konstatimi i kundërvajtjeve jashtë veprimtarisë normale të inspektimit.

-Rastet kur është kërkuar bashkëpunimi me policinë e shtetit.

-Telefonatat e kryera pranë Inspektoratit shtetëror dhe informacioni i dhënë ku çdo telefonues ka mundësinë e regjistrimit të denoncimeve për shkeljet e konstatuara nga subjektet.

ZYRA E KONTROLLIT TË BRENDSHËM (PERSONELIT)

Misioni dhe si është realizuar

Misioni i Zyrës së Kontrollit të Brendshëm është të mbështesë veprimtarinë e Inspektoratit shtetëror duke siguruar që: (1) qëllimet e Inspektoratit shtetëror janë plotësuar; (2) burimet e Inspektoratit shtetëror janë përdorur në përputhje me ligjet, rregulloret dhe politikat; (3) burimet janë të mbrojtura kundër keqpërdorimit dhe (4) të dhënat janë të besueshme dhe të sakta.

Organizimi dhe përgjegjësitë

Përbërja e Zyrës së Kontrollit të Brendshëm. Pajtueshmëria / Performanca e Zyrës së kontrollit për mbikëqyrjen e Inspektoratit shtetëror. Kontrolli i performancës së inspektorëve në përputhje me standardet e kontrollit profesional. Masat administrative të mara ndaj inspektorëve. Komente dhe shqyrtime të cilat rrisin përgjegjshmërinë dhe mbikëqyrjen për punën e inspektorëve.

INFORMACIONI FINANCËS

Raportohen të dhëna financiare të Inspektoratit shtetëror, si buxheti, të ardhurat nga gjobat dhe veprimtaria, projektet etj.

7. PUBLIKIMI

Publikimet dhe fushatat publicitare të realizuara nga Inspektorati shtetëror gjatë periudhës ushtrimore që po raportohet.

8. PROBLEMATIKA TË HASURA

Jepen të gjitha problemet e hasura nga Inspektoratit shtetëror gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj sipas legjislacionit përkatës.

9. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

10. OBJEKTIVAT PËR VITIN PASARDHËS

ANEKSI 2

Sr.	Treguesit e vlerësimit të veprimtarisë inspektuese	Përqindja (%) e peshës specifike për çdo tregues	Kritere të vlerësimit të treguesit	Vlerësimi 1	Vlerësimi 2	Vlerësimi 3	Vlerësimi 4
1	Inspektim të programuara	5	numri i inspektimeve të kryera brenda programit (numri i inspektimeve të kryera jashtë programit) numri i inspektimeve të kryera gjithsej	50%	20-50%	50-80%	80-100%
2	Inspektim të autorizuar	4	numri i autorizimeve me programin (numri i autorizimeve jashtë programit) numri i autorizimeve të gjeneruara	50%	20-50%	50-80%	80-100%
3	Njoftimi i inspektimeve	9	numri i inspektimeve të njoftuara (numri i inspektimeve të panjoftuara) numri i inspektimeve të kryera gjithsej	50%	20-50%	50-80%	80-100%
4	Kohëzgjatja e inspektimit	7	numri i inspektimeve për të cilat është kërkuar shtyrje e kohëzgjatjes së tyre apo atyre që kalojnë kohën maksimale të inspektimit në subjekt numri i përgjithshëm të inspektimeve	50%	20-50%	50-80%	80-100%
5	Rezultati nga marrje-mostrë	7	numri i shkeljeve të kërkesave ligjore të konstatuara nga analiza e mostrave numri i mostrave të marra	50%	20-50%	50-80%	80-100%
6	Masat urgjente të marra	8	numri i masave urgjente numri i procesverbalave të inspektimit	50%	20-50%	50-80%	80-100%
7	Revokimet nga ankimet administrative	4	numri i vendimeve të revokuara numri i ankimeve administrative gjithsej	80-100%	50-80%	20-50%	50%
8	Revokime nga vendime të gjykatës	4	numri i vendimeve të revuara numri i ankimeve gjyqësore gjithsej	80-100%	50-80%	20-50%	50%
9	Dënime administrative të vendosura	4	numri i dënimeve administrative të vendosura (ndjekja penale)	50%	20-50%	50-80%	80-100%
10	Shkelje e procedurës së inspektimit	10	numri i revokimeve për shkak të shkeljes së procedurës së inspektimit numri i ankimeve gjithsej	80-100%	50-80%	20-50%	50%
11	Respektimi i vendit të inspektimit	3	numri i inspektimeve të kryera jo në vendin e përcaktuar në autorizim numri i inspektimeve gjithsej	80-100%	50-80%	20-50%	50%
12	Dënime administrative të ekzekutuara	2	numri i dënimeve administrative kryesore apo plotëse të ekzekutuara numri i dënimeve administrative gjithsej	50%	20-50%	50-80%	80-100%
13	Numri i inspektimeve të kryera	2	numri i inspektimeve të kryera numri i inspektimeve të planifikuara	50%	20-50%	50-80%	80-100%
14	Dënime administrative globale në vlerë absolute	2	shuma absolute e gjobave të ardhura gjithsej	50%	20-50%	50-80%	80-100%
15	Rezultati e dokumentimit të procesit të inspektimit	10	numri i inspektimeve me shkelje të ndëshkuara me ecuri disiplinore për inspektorët numri i inspektimeve gjithsej	80-100%	50-80%	20-50%	50%
16	Etika dhe mallja e inspektorëve shtetërorë	4	numri i inspektorëve me shkelje të etikës numri i inspektorëve gjithsej	80-100%	50-80%	20-50%	50%
Treguesit specifike të vlerësimit të veprimtarisë inspektuese							
1	Treguesi i objektivit strategjik apo tjetër I		Kriteri i matshëm i vlerësimit				
2	Treguesi i objektivit strategjik apo tjetër II		Kriteri i matshëm i vlerësimit				

Shënim: Përqindja e peshës specifike (ne 100%) për çdo tregues të vlerësimit të veprimtarisë inspektuese dhe përshkrimi për secilin vlerësim 1, 2, 3 dhe 4 përcaktohet për secilin Inspektorat shtetëror, mbi bazën e të cilave bëhet një vlerësim unik i cili varion nga 1 në 4, sipas formulës $\frac{(1-n)^2}{5}$ e peshës specifike të faktorit x vlerësimi çdo faktorin përkatës.